



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

AGJENCIA KOMBËTARE E FINANCIMIT TË ARSIMIT TË LARTË
BORDI DREJTUES

Nr. 265/4 Prot.

Tiranë, më 26.11.2025

VENDIM
Nr. 14 Datë 26.11.2025

PËR

**“MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE MBI RENDITJEN E KËRKESAVE TË
STUDENTËVE TË CILËT DO TË PËRFITOJNË NGA SKEMA E KREDITIMIT
STUDENTOR”**

Bordi Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, në mbështetje të gërmës “c” të pikës 1 të nenit 11, të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të gërmës “c” të pikës 3 dhe gërmës “d” të pikës 6, të Vendimit nr.397, datë 03.05.2017 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL)”, të Vendimit nr.440, datë 19.07.2023 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e skemës së kreditimit studentor”, i ndryshuar si dhe në zbatim të Rregullores së Brendshme të Bordit Drejtues të AKFAL,

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare mbi renditjen e kërkesave të studentëve të cilët do të përfitojnë nga skema e kreditimit studentor, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit.
3. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI DREJTUES

KRYETARI

Erzen TOLA

ANËTARËT

Besmir BEÇA

Artan HOXHA

Agron KASA

Spiro BRUMBULLI